

Vëzhgim i procedurave të masave mbrojtëse

Përditësuar me: 10/16/18

Shënim: Ky dokument është përditësuar, që të jetë në përputhje me Departamenti e Arsimit Miçigan. Nuk është bërë asnjë ndryshim tjetër.



Departamenti i Edukimit Michigan
Zyra e Arsimit të veçantë Miçigan



Bordi Shtetëror i Edukimit

Cassandra E. Ulbrich, Bashkë-President

Richard Zeile Bashkë-President

Michelle Fecteau, Sekretar

Tom McMillin, Punonjës i thesarit

Nikki Snyder, Delegat i *NASBE* [*National Association of State Boards of Education* –
Shoqata Kombëtare e Bordeve të Shkollave të Arsimit]

Pamela Pugh

Lupe Ramos-Montigny

Eileen Lappin Eëiser

Ish-Zyrtar

Rick Snyder, Guvernator

Sheila A. Alles, Përgjegjës I Përkohëshëm i Shtetit



Departamenti i Arsimit Miçigan [*Michigan Department of Education (MDE)*]

Zyra e Arsimit të Veçant

608 West Allegan Street

P.O. Box 30008

Lansing, MI 48909

517-241-7075

[MDE faqja zyrtare](http://www.michigan.gov/mde) (www.michigan.gov/mde)

Akti i Arsimit për Individët me Aftësi të Kufizuara [*The Individuals with Disabilities Education Act (IDEA)*], ligji shtetëror që i përket arsimit të studentëve me aftësi të kufizuara, kërkon që shkollat tju mundësojnë prindërve të fëmijëve, një njoftim ku të parashtrahet një shpjegim i hollësishëm i procedurave të masave mbrojtëse nën tutelën e *IDEA* dhe politikave të Departamentit Amerikan të Arsimit. Një kopje e këtij njoftimi duhet ti jepet prindërve vetëm një herë në një vit shkollor, përvec rasteve të mëposhtme: (1) me kërkesën e prindit për vlerësim (2) në rastin kur krijohet ankesa e parë Shtetërore nën nenin 34 [*Code of Federal Regulations – Kodi i Rregulloreve Federale (CFR)*] §§300.151 përmes 300.153 dhe me mbërritjen e proces-ankesës nën nenin §300.507 ndodhur në një vit shkollor; (3) kur një vendim disiplinor merret me pasojë ndryshimin e vendosjes; (4) me kërkesën e prindit. [34 *CFR* §300.504(a)]

Kjo ankesë procedurjale e masave mbrojtëse duhet të ketë një shpjegim të plotë të të gjithë masave nën nenin §300.148 (vendosjen e njëanshme në një edukim privat me shpenzime publike), §§300.151 deri në 300.153 (procedurat e një ankimimi shtetëror), §300.300 (miratimi), §§300.502 deri në 300.503, §§300.505 deri në 300.518, dhe §§300.530 deri në 300.536 (masat mbrojtëse në Nënkatëgorinë E të pjesës B të politikave), dhe §§300.610 deri në 300.625 (kofidencialiteti i dispozitave të informacionit në nënkatëgorinë F).

Akronimet e mëposhtme janë përdorur në dokument:

ALJ	Gjyqtar I Ligjit Administrativ [<i>Administrative Law Judge</i>]
BIP	Plani i ndërhyrjes së Sjelljes [<i>Behavioral Intervention Plan</i>]
FAPE	Arsim i Duhur Publik Falas [<i>Free Appropriate Public Education</i>]
FERPA	Akti i të Drejtave Arsimore dhe Privacisë për Familjen [<i>Family Educational Rights and Privacy Act</i>]
FBA	Vlerësimi Funkcional i Sjelljes [<i>Functional Behavioral Assessment</i>]
IDEA	Akti i Arsimit për Individët me Aftësi të Kufizuara [<i>Individuals with Disabilities Education Act</i>]
IEE	Vlerësimi i pavarur i Arsimit [<i>Independent Educational Evaluation</i>]
IEP	Programi i Arsimit Individual [<i>Individualized Education Program</i>]
MDE	Departamenti i Arsimit Miçigan [<i>Michigan Department of Education</i>]
OSE	Zyra e Arsimit të Veçant [<i>Office of Special Education</i>]
SOAHR	Zyra shtetërore e dëgjimeve dhe rregullave administrative [<i>State Office of Administrative Hearings and Rules</i>]

Përmbajtja

Vëzhgim i procedurave të masave mbrojtëse	12
Informacione të Përgjithshme	12
Njoftim Paraprak me Shkrim (<i>Prior Written Notice</i>)	12
34 CFR §300.503.....	12
Njoftim.....	12
Përmbajtja e njoftimit	12
Përdorni një program të personalizuar si njoftim.	13
Njoftim në një gjuhë të kuptueshme.....	13
Gjuha amtare.	13
34 CFR §300.29	13
Posta Elektronike (<i>Electronic Mail</i>)	13
34 CFR §300.505.....	13
Miratim Prindëror – Përkufizimi.	14
34 CFR §300.9	14
Miratimi.....	14
Miratimi Prindëror	14
34 CFR §300.300.....	14
Miratim për vlerësim fillestar	14
Rregulla të vecanta për një vlerësim fillestar nga departamentet e Shtetit	15
Miratimi prindëror për shërbimet.....	15
Tërheqja e miratimit prindëror.....	16
Miratimi prindëror për rivlerësimin	16
Dokumentimi i përpjekjeve të arsyeshme për të marr miratimin prindëror	16
Kërkesa të tjera lidhur me miratimin	17

Vlerësimet e pavarura të Arsimit	17
34 CFR §300.502.....	17
Të Përgjithshme	17
Përkufizime.....	18
E drejta prindore për vlerësim me shpenzime publike	18
Vlerësime me nismën e prindit.....	19
Kërkesat për vlerësime nga një gjyqtar administrativ i ligjit	19
Kriteret e distriktit të shkollës.....	19
Konfidencialiteti i Informacionit	19
Përkufizime	19
34 CFR §300.611.....	19
Informacion Personalisht i Identifikueshëm	20
34 CFR §300.32	20
Njoftim për Prindërit	20
34 CFR §300.612.....	20
Të Drejtat e Qasjes	21
34 CFR §300.613.....	21
Të Dhënat e Qasjes	21
34 CFR §300.614.....	21
Të Dhënat për Më Shumë se Një Fëmijë	21
34 CFR §300.615.....	21
Listë e Llojeve dhe Vendndodhjeve të Informacionit	22
34 CFR §300.616.....	22
Tarifat	22
34 CFR §300.617.....	22
Ndryshimi i Të Dhënave pas Kërkesës së Prindit	22
34 CFR §300.618.....	22
Mundësia për Seancë Dëgjimore.....	22

34 CFR §300.619.....	22
Procedurat e Seancës Dëgjimore	22
34 CFR §300.621.....	22
Rezultati i Seancës Dëgjimore	23
34 CFR §300.620.....	23
Miratimi për Ndarjen e Informacioneve Personalisht të Identifikueshme	23
34 CFR §300.622.....	23
Masat mbrojtëse	24
34 CFR §300.623.....	24
Shkatërrimi i Informacionit	24
34 CFR §300.624.....	24
Të Drejtat e Studentit	24
34 CFR §300.625.....	24
Ndërmjetësimi	25
Ndërmjetësimi	25
34 CFR §300.506.....	25
Të Përgjithshme	25
Kërkesat.....	25
Paanshmëria e ndërmjetësit	26
Procedurat e Ankesave Shtetërore.....	27
Ndryshimi Midis Ankesave për Seanca Dëgjimore me Proces të Rregullt dhe Procedurave të Ankesave Shtetërore.....	27
Adoptimi i Procedurave të Ankesave Shtetërore	27
34 CFR §300.151.....	27
Të Përgjithshme	27
Riparimet për mohimin e shërbimeve të përshtatshme	27
Procedurat Minimale për Ankesat Shtetërore	28
34 CFR §300.152.....	28

Limiti kohor; procedurat minimale.....	28
Shtyrja e kohës; vendimi final; implementimi	28
Ankesat shtetërore dhe seancat dëgjimore të procesit të rregullt	29
Bërja e një Ankese Shtetërore.....	29
34 CFR §300.153.....	29
Procedura e procesit të ankesës	31
Plotësimi i një procesi ankimi	31
34 CFR §300.507.....	31
Të Përgjithshme	31
Informacion për prindërit.....	31
Proces Ankimi	31
34 CFR §300.508.....	31
Të Përgjithshme	31
Përmbajtja e ankesës.....	31
Njoftim i kërkuar përpara seancës dëgjimore të procesit të ankimit.....	32
Mjaftueshmëria e ankesës.....	32
Ndryshimi i ankesës	32
Përgjigja e shkollës së zonës ndaj një procesi ankese	32
Përgjigja e palës tjetër ndaj një procesi ankese.....	33
Model Formati.....	33
34 CFR §300.509.....	33
Vendodhja e Fëmijës Gjatë Procesit të Ankesës edhe Seancës Dëgjimore janë në pritje.....	33
34 CFR §300.518.....	33
Procesi i Zgjidhjes	34
34 CFR §300.510.....	34
Takimi i Zgjidhjes	34

Periudha e zgjidhjes	35
Ndryshime ndaj 30 ditëve kalendarike të periudhës së zgjidhjes	35
Marrëveshje me shkrim	36
Periudha e rishikimit të marrëveshjes	36
Seanca Dëgjimore e Procesit të Ankimit	37
Procedurat e seancës dëgjimore asnjëanëse.....	37
34 CFR §300.511.....	37
Të Përgjithshme	37
Gjykatës ligji administrativ i paanshëm	37
Çështja e procesit të dëgjimit	37
Koha për kërkesën e seancës dëgjimore.....	37
Përfundime të afateve.....	38
Të Drejtat në Seancën Dëgjimore	38
34 CFR §300.512.....	38
Të Përgjithshme	38
Informacione të shpallura shtesë	38
Të drejtat prinderore në seancën dëgjimore.....	38
Vendimet e Seancës Dëgjimore	39
34 CFR §300.513.....	39
Vendimet e gjykatësit të ligjit administrativ	39
Klauzola ndërtuese	39
Kërkesë e shkëputur për një Proces dëgjimi.....	39
Gjetjet edhe vendimet të panelit konsultativ edhe publikut të përgjithshëm	39
Apeli	40
Përfundimi i Vendimit; Appeal; Rishikim i Paanshëm	40
34 CFR §300.514.....	40

Përfundimi i vendimit i seancës dëgjimore	40
Afate edhe Lehtësi të Seancës Dëgjimore	40
34 CFR §300.515.....	40
Akt Civil, Përfshirë Periudhën Kohore në të Cilën Bëhen Këto Veprime	40
34 CFR §300.516.....	40
Të Përgjithshme	40
Limiti kohor	41
Procedura të mëtejshme	41
Juridiksioni i gjykatës së zonës	41
Rregullat e ndërtimit	41
Tarifat e Avokatëve	41
34 CFR §300.517.....	41
Të Përgjithshme	41
Shpërblimi i Tarifave	42
Procedurat Gjatë Disiplimit të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara.....	44
Autoriteti i Personelit të Shkollës	44
34 CFR §300.530.....	44
Përcaktimi rast-pas-rasti.....	44
Të Përgjithshme	44
Autoriteti shtesë	44
Shërbimet	45
Përcaktimi i Manifestimit.....	45
Përcaktimi nëse sjellja ishte një manifestim i paaftësisë së fëmijës	46
Rrethana të veçanta.....	46
Përkufizime.....	47
Njoftim	47
Ndryshimi i Vendorsjes për Shkak të Heqjes së Disiplinës.....	47

34 CFR §300.536.....	47
Përcaktimi i Vendorsjes	48
34 CFR § 300.531	48
Apelim.....	48
34 CFR § 300.532.....	48
Të Përgjithshme	48
Autoriteti i gjyqtarit të së drejtës administrative.....	48
Vendosja Gjatë Apelit	49
34 CFR §300.533.....	49
Mbrojtja për Fëmijët ende e Pa Pranueshme për Arsim Special dhe Shërbime të Ngjashme	49
34 CFR §300.534.....	49
Të Përgjithshme	49
Baza e njohurive për çështje disiplinore	50
Përjashtime	50
Kushtet që zbatohen nëse nuk ka bazë të dijes	50
Referimi dhe Veprimi nga Autoritetet e Zbatimit të Ligjit dhe Gjyqësorit.....	51
34 CFR §300.535.....	51
Transmetimi i të dhënave	51
Kërkesat për Vendorsjen e Njëanshme nga Prindërit e Fëmijëve në Shkollat Private me Shpenzime Publike.....	52
Të Përgjithshme.....	52
34 CFR §300.148.....	52
Rimbursimi për vendorsjen në shkollë private	52
Kufizimi i rimbursimit	52
Transferimi i të Drejtave Prindërore në Moshën Madhore.....	53
34 CFR §300.520.....	53
Shtojca A - Përkufizime Federale.....	54

Lëndim i rëndë trupor	54
18 USC 1365(h)	54
Armë	54

Vëzhgim i procedurave të masave mbrojtëse

Informacione të Përgjithshme

Njoftim Paraprak me Shkrim

34 CFR §300.503

Njoftim

Distrikti juaj shkollor (termi "distrikt shkollor," I përdorur në këtë Njoftim, i referohet një akademie publike shkollë) duhet tju jap një njoftim me shkrim (duke ju dhënë një informacion të shkruar), sa herë që:

1. Propozon të nisi apo të ndryshojë identifikimin, vlerësimin, apo vendin e arsimit të fëmijës suaj, apo ofrimin e një arsimit të duhur publik [*Free Appropriate Public Education (FAPE)*] për fëmijën tuaj; ose
2. Refuzon të inicioj apo ndryshoj identifikimin, vlerësimin, apo vendin e arsimit të fëmijës suaj, apo sigurimin e *FAPE*.

Përmbajtja e njoftimit

Njoftimi i shkruar duhet:

1. Përshkruaj veprimin që distrikti i shkollës propozon apo refuzon të ndërmerret;
2. Shpjego pse shkolla e distriktit tuaj propozon apo refuzon të ndërmerret veprimin;
3. Përshkruaj cdo procedurë vlerësimi, përlllogaritje, shënimi apo raporti që shkolla juaj ka përdorur në vendimmarrjen e saj për të propozuar apo refuzuar veprimin;
4. Përfshini një pohim ku ju jeni nën dispozitat e procedurave të mbrojtjes në pjesën B të *IDEA*;
5. Tju tregoj si mund të merrni një përshkrim të procedurave mbrojtëse nëse propozimi apo refuzimi i shkollës suaj bie ndesh me vlerësimin tuaj;
6. Të përfshihen burime që ju mund të kontaktoni për tju ndihmuar të kuptoni pjesën B të *IDEA*;
7. Përshkruani cdo zgjedhje që skuadra e programit individual të arsimit [*Individualized Education Program (IEP)*] për fëmijën tuaj, zgjedhi dhe arsyet për refuzimin e këtyre zgjedhjeve; dhe
8. Jepni një përshkrim të arsyeve të tjera se pse shkolla e distriktit tuaj propozoi apo refuzoi vendimin.

Përdorni një program të personalizuar si njoftim.

Një agjensi publike mund ta përdor *IEP* si pjesë e një njoftimi të parashtruar me shkrim për sa kohë dokumenti(et) që iu dërgohen prindërve janë në përputhje me të gjithë kërkesat §300.503.

Njoftim në një gjuhë të kuptueshme

Njoftimi duhet të jetë:

1. Shkruar në një gjuhë të kuptueshme për publikun e gjërë; dhe
2. I dhënë në gjuhën tuaj amtare apo në atë që përdorni për komunikim, përjashtuar faktit nëse është e pamundur.

Nëse gjuha juaj amtare apo ndonjë metodë tjetër komunikimi nuk është e shkruar, shkolla juaj duhet të siguroj:

1. Njoftimi është përkthyer për ju gojarisht në gjuhën tuaj amtare apo në ndonjë mënyrë tjetër komunikimi;
2. Ju kuptoni përmbajtjen e njoftimit; dhe
3. Ka dëshmi të shkruara që 1 dhe 2 janë përmbushur.

Gjuha amtare.

34 CFR §300.29

Gjuha amtare, kur përdoret me një individ që ka përdorim të cunguar të gjuhës angleze, domethënë si në vazhdim:

1. Gjuha e përdorur normalisht nga një person, apo, në rastin e një fëmije, gjuha e përdorur nga prindërit e fëmijës;
2. Në të gjithë kontaktet direkte me një fëmijë (përfshirë vlerësimin e një fëmije), gjuha që përdoret zakonisht është ajo që është prezente në shtëpinë e fëmijës apo në mjedisin mësimor.

Për një person të shurdhët apo memec, apo për një person pa një gjuhë të shkruar, mënyra e komunikimit, është ajo që një person përdor normalisht (si gjuha e shenjave, Braille, apo gjuha e folur)

Posta Elektronike

34 CFR §300.505

If your school district offers parents the choice of receiving documents by e-mail, you may choose to receive the following by e-mail:

1. Njoftim paraprak me shkrim;
2. Njoftim për procedurat mbrojtëse; dhe
3. Njoftime lidhur me një proces ankimor.

Miratim Prindëror – Përkufizimi.

34 CFR §300.9

Miratimi

Miratim domethënë

1. Jeni informuar plotësisht në gjuhën tuaj amtare apo ndonjë mënyrë tjetër komunikimi (si gjuha e shenjave, Braille, apo komunikimi gojor) nga të gjithë informacionet rreth veprimeve për të cilat ju po i miratoni.
2. Ju kuptoni dhe bini dakort me shkrim për këtë veprim, dhe miratimi përshkruan se veprimi dhe lista me të dhëna (nëse ka) do të lirohet;
3. Ju do të kuptoni se miratimi është vullnetar nga ana juaj dhe ju mund të tërhiqni miratimin në cdo kohë.

Terheqja e miratimit tuaj nuk e zhben veprimin që ka ndodhur pasi dhatë miratimin dhe para se ta tërhiqnit.

Miratimi Prindëror

34 CFR §300.300

Miratim për vlerësim fillestar

Shkolla juaj nuk mund të jap një vlerësim fillestar të fëmijës suaj për të përcaktuar nëse fëmija juaj kualifikohet në pjesën B të *IDEA* për të marrë arsim të vecant dhe shërbime të ngjashme, pa dhënë fillimisht njoftim paraprak me shkrim të veprimit në fjalë dhe pa marrë miratim nga **Miratimi i prindit – Përkufizimi**.

Shkolla juaj duhet të bëjë përpjekjet e duhura për të marrë miratimin tuaj për një vlerësim fillestar për vendimin nëse fëmija juaj është një fëmijë me aftësi të kufizuara ose jo.

Miratimi juaj për një vlerësim fillestar *nuk* domethënë se ju duhet të jepni gjithashtu miratimin që shkolla të fillojë të japë mësim të vecanta dhe shërbime të ngjashme për fëmijën tuaj.

Nëse fëmija juaj është regjistruar në një shkollë publike ose ju po kërkon ta regjistroni atë, dhe keni refuzuar të jepni miratimin ose të përgjigjeni kërkesës, shkolla mund, por nuk është e detyruar të, fillojë një vlerësim fillestar duke përdorur Aktin ose ankesën e procesit të rregullt ligjor, mbledhjen e zgjidhjes dhe procedurat e paanshme të dëgjimit të procesit të rregullt ligjor. Distrikti i shkollës nuk do të dhunojë detyrimin për të lokalizuar, identifikuar, dhe vlerësuar fëmijën tuaj nëse nuk ndjek një vlerësim të fëmijës në këto rrethana. Your school district will not violate its obligations to locate, identify, and evaluate your child if it does not pursue an evaluation of your child in these circumstances

Rregulla të vecanta për një vlerësim fillestar nga departamentet e Shtetit

Nëse një fëmijë është nën mbrojtjen e shtetit dhe nuk jeton me prindërit e tij/saj —

Shkollës nuk i duhet miratimi nga prindërit për një vlerësim fillestar që të vendos nëse fëmija është më aftësi të kufizuara apo jo, nëse:

1. Pavarësisht mundit të arsyeshëm për ta bërë, shkolla nuk gjen prindërit e fëmijës;
2. Të drejtat e prindërve janë hequr në bazë të Shtetit të së Drejtës; apo
3. Një gjyqtar apo një agjensi publike me përgjegjësi për kujdesin e përgjithshëm të fëmijës ka dhënë të drejtën një individ tjetër për fëmijën, në vend të prindit.

I mbrojtur nga shteti, përdorur në IDEA, domethënë një fëmijë I cili është:

1. Një fëmijë i birësuar, vetëm nëse prindërit birësues u është dhënë e drejta të marrin vendime rreth arsimit për fëmijën, nga një gjyqtar, apo një agjensi publike me përgjegjësinë mbi kujdesin e përgjithshëm ndaj fëmijës;
2. Konsiderohet i mbrojtur nga shteti nën ligjin e Shtetit;
3. Konsiderohet i mbrojtur nga gjykata nën ligjin e Shtetit; ose
4. Nën tutelën e një agjencie për kujdesin e fëmijëve.

Miratimi prindëror për shërbimet

Distrikti i shkollës duhet të marr miratimin tuaj para se të jap shërbime të vecanta arsimit dhe shërbime të lidhura me fëmijën për herë të parë.

Nëse nuk përgjigjeni ndaj kërkesës për të miratuar arsimin e vecant për fëmijën tuaj dhe shërbime të ngjashme për herë të parë, apo nëse refuzoni të jepni miratimin, distrikti i shkollës suaj mund të mos përdor masat procedurale të mbrojtjes (prsh. Ndërhyrje, për shkak ankese) në mënyrë që të bien në një ujdë për një proces të vecant arsimit (rekomanduar nga ekipi I fëmijës tuaj *IEP*-Programi I arsimit individual) mund të sigurohet për fëmijën tuaj pa miratimin tuaj.

Nëse refuzoni të jepni miratimin për të marr arsim të vecant dhe shërbime të ngjashme për herë të parë, apo nëse nuk përgjigjeni një kërkesë për të dhënë miratimin tuaj, dhe shkolla nuk ju jep shërbimin për fëmijën, shkolla juaj:

1. Nuk është dhunim i kërkesës që *FAPE* të jetë i mundur për Nuk bie ndesh me kërkesën për të bërë *FAPE* të mundur për fëmijën tuaj, në lidhje me shërbimet që i ofrohen fëmijës;
2. Nuk është kërkesë organizimi i një mbledhje *IEP*, apo zhvillimi I *IEP* për fëmijën lidhur me arsimin e vecant dhe shërbime lidhur me te, për të cilat miratimi juaj ishte kërkuar.

Tërheqja e miratimit prindëror

Nëse informoni distriktin e shkollës me shkrim se ju tërhiqni miratimin tuaj për arsim të vecant për fëmijën tuaj, shkolla:

1. Mund të mos vazhdoj ti jap të drejtën e arsimit të vecant dhe shërbimeve lidhur me të për fëmijën tuaj;
2. Duhet të mundësoni më parë një njoftim me shkrim, në përputhje me §300.503 të ligjeve të *IDEA*, rreth propozimit për ndërprerje të arsimit të vecant dhe shërbimeve të ngjashme bazuar në marrjen e tërheqjes së miratimit tuaj;
3. Nuk mund të përdorë procedurat e procesit (prsh. ndërmjetësim, mbledhje rezolutës ose dëgjim i paanshëm i procesit të rregullt ligjor) në mënyrë që të arrihet marrveshja apo vendimi lidhur me shërbimet që do ti mundësohen fëmijës suaj;
4. Nuk është në kundërshtim me kërkesën për të bërë *FAPE* në dispozicion të fëmijës tuaj për dështimin e saj për të ofruar arsimim të mëtejshëm të veçantë dhe shërbime të lidhura me fëmijën tuaj;
5. Nuk kërkohet që të ketë një mbledhje të *IEP* ose të zhvillojë një *IEP* për fëmijën tuaj për ofrimin e mëtejshëm të arsimit special dhe shërbimeve përkatëse; dhe
6. Nuk është e nevojshme të ndryshoni të dhënat e edukimit të fëmijës tuaj për të hequr ndonjë referencë për pranimin e fëmijës suaj të arsimit special dhe shërbimeve përkatëse për shkak të revokimit të miratimit.

Miratimi prindëror për rivlerësimin

Distrikti juaj shkollor duhet të marrë miratimin tuaj të informuar para se ta rivlerësojë fëmijën tuaj, përveç nëse distrikti juaj shkollor mund ta dëshmojë atë:

1. U morën hapa të arsyeshëm për të marr miratimin për rivlerësimin e fëmijës suaj; dhe
2. Ju nuk u përgjigjët.

Nëse ju refuzoni të miratoni rivlerësimin e fëmijës suaj, distrikti I shkollës mund, por nuk është i detyruar të, ndjek rivlerësimin e fëmijës suaj duke përdorur ndërmjetësimin, ankesat në lidhje me procesin, mbledhje konkluzuese dhe seancë dëgjimore të paanshëme të procesit për të vendosur anashkalimin e refuzimit të miratimit për rivlerësimin e fëmijës suaj. Ashtu si me vlerësimet fillestare, distrikti juaj shkollor nuk i shkel detyrimet e tij sipas Pjesës B të *IDEA* nëse nuk refuzon të ndjekë rivlerësimin në këtë mënyrë.

Dokumentimi i përpjekjeve të arsyeshme për të marr miratimin prindëror

Shkolla juaj duhet të ketë dokumentacion lidhur me përpjekjet e arsyeshme për të marr miratimin prindëror për vlerësimet fillestare, për të dhënë arsim të vecant dhe shërbime të ngjashme për herë të parë, për rivlerësimin dhe për të lokalizuar

prindërit e të mbrojturit të shtetit, në lidhje me vlerësimet fillestare.

Dokumentacioni duhet të përfshijë një regjistër të përpjekjeve të distriktit shkollor në këto zona, si:

1. Të dhëna të hollësishme të thirrjeve telefonike të bëra dhe rezultatet e atyre thirrjeve;
2. Kopje të korrespondencës dërguar prindërve dhe çdo përgjigje të marrë; dhe
3. Të dhënat e hollësishme të vizitave të bëra në shtëpinë ose vendin e punës së prindërve dhe rezultatet e atyre vizitave.

Kërkesa të tjera lidhur me miratimin

Miratimi juaj nuk kërkohet para se distrikti juaj shkollor të:

1. Rishikimi i të dhënave ekzistuese si pjesë e vlerësimit të fëmijës suaj ose rivlerësimi; ose
2. Jepni fëmijës tuaj një provë ose një vlerësim tjetër që u jepet të gjithë fëmijëve, përveç nëse para se të bëhet test ose vlerësim, kërkohet miratimi nga të gjithë prindërit e të gjithë fëmijëve.

Distrikti juaj shkollor nuk mund të përdorë refuzimin tuaj për të dhënë miratimin për një shërbim ose veprimtari që t'i mohojë juve ose fëmijës suaj ndonjë shërbim, përfitim ose aktivitet tjetër.

Nëse e keni regjistruar fëmijën tuaj në një shkollë private me shpenzimet tuaja, ose nëse jeni në shkollim në shtëpi për fëmijën tuaj dhe nuk jepni miratimin tuaj për vlerësimin fillestar të fëmijës suaj ose rivlerësimin e fëmijës suaj, ose nuk i përgjigjeni kërkesës për të siguruar miratimin tuaj, distrikti shkollor mund të mos e përdorë miratimin e tij për të anuluar procedurat (p.sh., ndërmjetësimi, ankimi i procesit të rregullt, takimi i rezolutës ose dëgjimi i procesit të rregullt të paanshëm) dhe nuk është e nevojshme të konsideroni fëmijën tuaj si të drejtë për të marrë shërbime të barabarta për fëmijët me aftësi të kufizuara të shkollave private të vendosura në mënyrë parësore).

Vlerësimet e pavarura të Arsimit

34 CFR §300.502

Të Përgjithshme

Siç përkruhet më poshtë, ju keni të drejtë të merrni një Vlerësimi Edukativ të Pavarur [*Independent Educational Evaluation (IEE)*] të fëmijës tuaj nëse nuk pajtoheni me vlerësimin e fëmijës suaj të fituar nga distrikti juaj shkollor.

Nëse kërkoni një *IEE*, distrikti shkollor duhet t'ju ofrojë informata se ku mund të merrni një *IEE* dhe rreth kritereve të distriktit shkollor që zbatohen në *IEE*.

Përkufizime

IEE nënkupton një vlerësim të kryer nga një ekzaminues i kualifikuar i cili nuk është i punësuar nga distrikti shkollor përgjegjës për edukimin e fëmijës suaj.

Shpenzimet publike do të thotë që distrikti shkollor ose paguan për koston e plotë të vlerësimit ose siguron që vlerësimi është siguruar ndryshe pa asnjë kosto, në përputhje me dispozitat e Pjesës B të *IDEA*, të cilat lejojnë çdo shtet të përdorë çfarëdo shteti, burime lokale, federale dhe private të mbështetjes janë në dispozicion në shtet për të përmbushur kërkesat e Pjesës B të Aktit.

E drejta prindore për vlerësim me shpenzime publike

Ju keni të drejtën për *IEE* të fëmijës suaj me shpenzime publike nëse nuk pajtoheni me një vlerësim të fëmijës tuaj të marrë nga distrikti juaj shkollor, në varësi të kushteve të mëposhtme:

1. Nëse paraqitni një kërkesë me shkrim për një *IEE* të fëmijës tuaj me shpenzime publike, distrikti juaj shkollor duhet t'i përgjigjet me shkrim kërkesës brenda shtatë ditëve kalendarike nga marrja e kërkesës, duke treguar qëllimin e distriktit për: (a) sigurojë *IEE* me shpenzime publike; ose (b) të paraqesë një ankesë të procesit të rregullt ligjor për të kërkuar një seancë dëgjimore për të treguar se vlerësimi i fëmijës suaj është i përshtatshëm.
2. Nëse distrikti juaj shkollor kërkon një seancë dhe vendimi përfundimtar është se vlerësimi i distriktit shkollor të fëmijës tuaj është i përshtatshëm, ju keni të drejtë të keni një *IEE*, por jo me shpenzime publike.
3. Nëse kërkon një *IEE* të fëmijës suaj, distrikti shkollor mund të pyesë pse ju kundërshtoni vlerësimin e fëmijës suaj të marrë nga distrikti juaj shkollor. Megjithatë, distrikti juaj shkollor nuk mund të kërkojë një shpjegim dhe nuk mund të vonojë pa arsye ose dhënien e *IEE*-së të fëmijës suaj me shpenzime publike ose paraqitjen e një ankese të rregullt ligjor për të kërkuar një seancë dëgjimore të procesit të rregullt ligjor për të mbrojtur vlerësimin e distriktit shkollor të fëmijës suaj.
4. Nëse një *IEE* që merrni nuk plotëson kriteret e distriktit shkollor, distrikti shkollor mund të paraqesë një ankesë të procesit të rregullt ligjor. Nëse vendimi përfundimtar në seancë është se vlerësimi nuk i plotëson kriteret e distriktit shkollor, rimbursimi publik i shpenzimeve të *IEE*-së mund të mohohet.

Ju keni të drejtë vetëm për një *IEE* të fëmijës suaj me shpenzime publike çdo herë që distrikti juaj shkollor të bëjë një vlerësim të fëmijës suaj me të cilën ju nuk pajtoheni.

Vlerësime me nismën e prindit

Nëse merrni një *IEE* të fëmijës suaj me shpenzime publike ose ndani me rrethin shkollor një vlerësim të fëmijës suaj që keni marrë me shpenzime private:

1. Distrikti juaj shkollor duhet të marrë parasysh rezultatet e vlerësimit të fëmijës suaj, nëse i plotëson kriteret e distriktit shkollor për *IEE*-të, në çdo vendim të marrë në lidhje me ofrimin e një *FAPE* për fëmijën tuaj; dhe
2. Ju ose distrikti juaj shkollor mund ta paraqesni vlerësimin si dëshmi në një proces të rregullt ligjor lidhur me fëmijën tuaj.

Kërkesat për vlerësime nga një gjyqtar administrativ i ligjit

Nëse një gjykatës i së drejtës administrative [*Administrative Law Judge (ALJ)*] kërkon *IEE* të fëmijës suaj si pjesë e një seance dëgjimore të procesit të rregullt ligjor, kostoja e vlerësimit duhet të jetë me shpenzime publike.

Kriteret e distriktit të shkollës

Nëse një *IEE* është me shpenzime publike, kriteret sipas të cilave është marrë vlerësimi, duke përfshirë vendndodhjen e vlerësimit dhe kualifikimet e ekzaminuesit, duhet të jenë të njëjta me kriteret që distrikti shkollor përdor kur fillon një vlerësim (për shtrirja e këtyre kriterëve janë në përputhje me të drejtën tuaj për një *IEE*).

Përveç kriterëve të përshkruara më sipër, një distrikt shkollor nuk mund të vendosë kushte apo afate lidhur me marrjen e një *IEE* me shpenzime publike.

Konfidencialiteti i Informacionit

Përkufizime

34 CFR §300.611

Siç përdoret nën titullin **Konfidencialiteti i Informacionit**:

- *Shkatërrimi* nënkupton shkatërrimin fizik apo heqjen e identifikuesve personalë nga informacioni në mënyrë që informacioni të mos jetë më personalisht i identifikueshëm.
- *Të dhëna edukimi* nënkupton llojin e të dhënave të mbuluara nga përkufizimi i "të dhëna edukimi" në 34 CFR Pjesa 99 (rregulloret që implementojnë Aktin për Të Drejtat e Edukimit dhe Privatësisë të Familjes [*Family Educational Rights and Privacy Act (FERPA)*] i 1974, 20 U.S.C. [*United States Code – Shoqata Kombëtare e Bordeve të Shkollave të Arsimit*] 1232g). *FERPA* përkufizon "të dhëna edukimi" si të dhëna që lidhen drejtpërdrejt me një student dhe mbahen nga një agjensi edukimi apo palë që vepron për agjensinë.

- *Agjensi pjesëmarrëse* nënkupton çdo distrikt shkollor, agjensi apo institucion që mbledh, mirëmban apo përdor informacione personalisht të identifikueshme, ose nga të cilat merret informacion, sipas Pjesës B të *IDEA*.

Informacion Personalisht i Identifikueshëm

34 CFR §300.32

Personalisht i identifikueshëm nënkupton informacion që ka:

- a. Emrin e fëmijës tuaj, emrin tuaj si prind, ose emrin e një anëtari tjetër të familjes;
- b. Adresën e fëmijës tuaj;
- c. Një identifikues personal, si numri i sigurimeve shoqërore apo numri i studentit të fëmijës tuaj; ose
- d. Një listë me karakteristika personale apo informacione të tjera që do të bënin të mundur identifikimin e fëmijës me siguri të konsiderueshme.

Njoftim për Prindërit

34 CFR §300.612

Departamenti i Edukimit të Miçiganit [*Michigan Department of Education (MDE)*] duhet të njoftojë prindërit që *MDE* ka procedura dhe politika që mundën të njoftojnë prindërit plotësisht mbi konfidencialitetin e informacioneve personalisht të identifikueshme, duke përfshirë:

1. Një përshkrim të nivelit deri në të cilin jepet njoftimi në gjuhët amëtare të grupeve të ndryshme të popullsisë në Shtet;
2. Një përshkrim të fëmijëve për të cilët mbahet informacion personalisht i identifikueshëm, llojet e informacionit të kërkuara, metodat të cilat Shteti synon të përdorë për mbledhjen e informacionit (përfshirë burimet nga të cilat merret informacion) dhe përdorimet e këtij informacioni;
3. Një përmbledhje e politikave dhe procedurave që duhet të ndjekin agjensitë pjesëmarrëse lidhur me ruajtjen, ndarjen me palë të treta, mbajtjen dhe shkatërrimin e informacioneve personalisht të identifikueshme; dhe
4. Një përshkrim të gjitha të drejtave të prindërve dhe fëmijëve lidhur me këtë informacion, përfshirë të drejtat sipas *FERPA* dhe rregulloret e implementimit në 34 CFR Pjesa 99.

Para çdo aktiviteti identifikimi madhor, gjetjeje apo vlerësimi (njohur edhe si “gjetje fëmije”), njoftimi duhet të publikohet apo shpallet në gazeta dhe media të tjera, ose të dyja, me tirazh të majftueshëm për të njoftuar prindërit në të gjithë Shtetin për aktivitetin për gjetjen, identifikimin dhe vlerësimin e fëmijës në nevojë për edukim special dhe shërbime të ngjashme.

Të Drejtat e Qasjes

34 CFR §300.613

Agjensia pjesëmarrëse duhet t'ju lejojë të kontrolloni dhe rishikoni të gjitha të dhënat e edukimit lidhur me fëmijën tuaj, të cilat janë mbledhur, mirëmbajtur apo përdorur nga agjensia pjesëmarrëse sipas Pjesës B të *IDEA*. Agjensia pjesëmarrës duhet të përmbushë kërkesë tuaj për të kontrolluar dhe rishikuar çdo të dhënë edukimi mbi fëmijën tuaj pa vonesa të panevojshme dhe para çdo takimi lidhur me një *IEP*, ose një seance dëgjimore të një procesi të rregullt të paanshëm (përfshirë një takim zgjidhës apo një seancë dëgjimore lidhur me disiplinën), dhe në asnjë rast më shumë se 45 ditë kalendarike pas bërjes së kërkesës.

E drejta juaj për të kontrolluar dhe rishikuar të dhënat e edukimit përfshin:

1. Të drejtën tuaj për një përgjigje nga agjensia pjesëmarrëse lidhur me kërkesat tuaja të arsyeshme për shpjegime dhe interpretime të të dhënave;
2. Të drejtën tuaj për të kërkuar që agjensia pjesëmarrëse t'ju japë kopje të të dhënave nëse nuk mundeni t'i kontrolloni dhe rishikoni në mënyrë efektive nëse nuk keni kopje; dhe
3. Të drejtën për të patur një përfaqësues që të kontrollojë dhe rishikojë të dhënat.

Agjensia pjesëmarrëse mund të supozojë se ju keni autoritetin e duhur për të kontrolluar dhe rishikuar të dhënat lidhur me fëmijën tuaj, nëse nuk vihet në dijeni se ju nuk e keni këtë autoritet sipas ligjeve në fuqi të Shtetit për këto çështje si kujdestaria, ndarja apo divorci.

Të Dhënat e Qasjes

34 CFR §300.614

Çdo agjensia pjesëmarrëse duhet të mbajë të dhëna për palët që kanë qasje tek të dhënat e edukimit të mbledhura, mirëmbajtura apo përdorura sipas Pjesës B të *IDEA* (përveç aksesit nga prindërit dhe punonjës të autorizuar të agjensisë pjesëmarrëse), duke përfshirë emrin e palës, datën e dhënies së qasjes, dhe qëllimin për të cilin kjo palë është autorizuar për të përdorur të dhënat.

Të Dhënat për Më Shumë se Një Fëmijë

34 CFR §300.615

Nëse të dhënat e edukimit përfshijnë informacion për më shumë se një fëmijë, prindërit e këtyre fëmijëve kanë të drejtë të kontrollojnë dhe rishikojnë vetëm të dhënat lidhur me fëmijën e tyre apo të informohen lidhur me atë informacion specifik.

Listë e Llojeve dhe Vendndodhjeve të Informacionit

34 CFR §300.616

Pas kërkesës, çdo agjensi pjesëmarrëse duhet t'ju ofrojë një listë të llojeve dhe vendndodhjeve të të dhënave të edukimit të mbledhura, mirëmbajtura apo përdorura nga agjensia.

Tarifat

34 CFR §300.617

Çdo agjensi pjesëmarrëse mund të ketë një tarifë për kopjet e të dhënave që bëhen për ju sipas Pjesës B të *IDEA*, nëse tarifa nuk ndikon në mënyrë efektive në ushtrimin e të drejtës tuaj për të kontrolluar dhe rishikuar të dhënat.

Një agjensi pjesëmarrëse nuk mund të ketë tarifë për të kërkuar apo për të marrë informacion sipas Pjesës B të *IDEA*.

Ndryshimi i Të Dhënave pas Kërkesës së Prindit

34 CFR §300.618

Nëse ju besoni se informacioni në të dhënat e edukimit lidhur me fëmijën tuaj të mbledhura, mirëmbajtura apo përdorura sipas Pjesës B të *IDEA* është i pasaktë, i keqkuptueshëm apo shkel privatësinë ose të drejta të tjera të fëmijës tuaj, ju mund t'i kërkonit agjensisë pjesëmarrëse e cila mban këtë informacion që ta ndryshojë atë.

Agjensia pjesëmarrëse duhet të vendosë nëse do e ndryshojë informacionin sipas kërkesës tuaj brenda një afati kohor të arsyeshëm që nga marrja e kërkesës tuaj.

Nëse agjensia pjesëmarrëse refuzon ta ndryshojë informacionin sipas kërkesës tuaj, duhet t'ju informojë mbi refuzimin dhe t'ju këshillojë lidhur me të drejtën për një seancë dëgjimore siç përshkruhet nën titullin Mundësia për Seancë Dëgjimore.

Mundësia për Seancë Dëgjimore

34 CFR §300.619

Agjensia pjesëmarrëse duhet, pas kërkesës, t'ju ofrojë një mundësi për seancë dëgjimore për ndryshimin e informacionit në të dhënat e edukimit të fëmijës tuaj për t'u siguruar se nuk është i pasaktë, i keqkuptueshëm apo shkel privatësinë ose të drejta të tjera të fëmijës tuaj.

Procedurat e Seancës Dëgjimore

34 CFR §300.621

Një seancë dëgjimore për ndryshimin e informacionit në të dhënat e edukimit duhet të bëhet në përputhje me procedurat për seanca të tilla dëgjimore sipas *FERPA*.

Rezultati i Seancës Dëgjimore

34 CFR §300.620

Nëse, si rezultat i seancës dëgjimore, agjensia pjesëmarrëse vendos se informacioni është i pasaktë, i keqkuptueshëm apo shkel privatësinë ose të drejta të tjera të fëmijës, duhet të ndryshojë informacionin në fjalë dhe t'ju informojë me shkrim.

Nëse, si rezultat i seancës dëgjimore, agjensia pjesëmarrëse vendos se informacioni nuk është i pasaktë, i keqkuptueshëm apo nuk shkel privatësinë ose të drejta të tjera të fëmijës tuaj, duhet t'ju njoftojë mbi të drejtën tuaj për të shtuar tek të dhënat që mban mbi fëmijën tuaj një deklaratë ku komentoni mbi informacioni apo shtroni arsyet përse nuk jeni dakort me vendimin e agjensisë pjesëmarrëse.

Ky shpjegim i shtuar tek të dhënat e fëmijës tuaj duhet:

1. Të mirëmbahet nga agjensia pjesëmarrëse si pjesë e të dhënave të fëmijës tuaj për sa kohë informacioni i kundërshtuar mbahet nga agjensia pjesëmarrëse; dhe
2. Nëse agjensia pjesëmarrëse ndan të dhënat e fëmijës tuaj apo pjesën e diskutuar me ndonjë palë, edhe shpjegimi duhet t'i jepet kësaj pale.

Miratimi për Ndarjen e Informacioneve Personalisht të Identifikueshme

34 CFR §300.622

Nëse ndarja e informacioneve personalisht të identifikueshme në të dhënat e edukimit (pa miratimin e prindërve) nuk është i autorizuar nga *FERPA*, duhet të merret miratimi yt para se informacionet personalisht të identifikueshme të ndahen me palë të tjera përveç zyrtarëve të agjensive pjesëmarrëse. Përveç rrethanave të specifikuara më poshtë, miratimi juaj nuk kërkohet para se informacionet personalisht të identifikueshme t'i lëshohen zyrtarëve të agjensive pjesëmarrëse me qëllim përmbushjen e kërkesave të Pjesës B të *IDEA*.

Miratimi juaj, apo miratimi i një fëmije që ka arritur moshën madhore sipas ligjeve të Shtetit, duhet të merret para se informacionet personalisht të identifikueshme t'i lëshohen agjensive pjesëmarrëse që ofrojnë apo paguajnë për shërbime tranzitore.

Nëse fëmija juaj është ose do të jetë, në një shkollë private që nuk ndodhet në të njëjtin distrikt shkollor ku ju banoni, miratimi juaj duhet të merret para se çdo informacion personalisht i identifikueshëm mbi fëmijën tuaj të lëshohet midis zyrtarëve në distriktin shkollor ku ndodhet shkolla private dhe zyrtarëve në distriktin shkollor ku ju banoni.

Masat mbrojtëse

34 CFR §300.623

Çdo agjensi pjesëmarrëse duhet të mbrojë konfidencialitetin e informacioneve personalisht të identifikueshme në fazat e mbledhjes, ruajtjes, ndarjes dhe shkatërrimit.

Një zyrtar në çdo agjensi pjesëmarrëse duhet të mbajë përgjegjësi për sigurimin e konfidencialitetit të çdo informacioni personalisht të identifikueshëm.

Të gjithë personat që mbledhin apo përdorin informacion personalisht të identifikueshëm duhet të trajnohen apo të marrin udhëzime lidhur me politikat dhe procedurat e Miçiganit lidhur me konfidencialitetin sipas Pjesës B të *IDEA* dhe *FERPA*.

Çdo agjensi pjesëmarrëse duhet të mirëmbajë, për kontroll publik, një listë aktuale të emrave dhe pozicioneve të këtyre punonjësve brenda agjensisë që mund të kenë akses tek informacionet personalisht të identifikueshme.

Shkatërrimi i Informacionit

34 CFR §300.624

Distrikti juaj shkollor duhet t'ju informojë kur informacionet personalisht të identifikueshme që mbledhen, mirëmbahen apo përdoren sipas Pjesës B të *IDEA* nuk nevojiten më për t'i ofruar shërbime edukimi fëmijës tuaj.

Informacioni duhet të shkatërrohet sipas kërkesës tuaj. Sidoqoftë, të dhëna të përhershme lidhur me fëmijën tuaj si emri i fëmijes, adresa dhe numri i telefonit, notat, mungesat, lëndët e ndjekura, niveli dhe viti i përfundimit mund të mbahen pa limit kohor.

Të Drejtat e Studentit

34 CFR §300.625

Sipas rregulloreve të *FERPA*, të drejtat e prindërve lidhur me të dhënat e edukimit i transferohen studentit në moshën 18 vjeçare.

Të drejtat e prindërve sipas Pjesës B të *IDEA* lidhur me të dhënat e edukimit gjithashtu i transferohen studentit në moshën 18 vjeçare. Sidoqoftë, një agjensi pjesëmarrëse duhet të njoftojë siç kërkohet nga Pjesa B e *IDEA* si studentin ashtu edhe prindërit.

Ndërmjetësimi

Ndërmjetësimi

34 CFR §300.506

Të Përgjithshme

MDE ka procedura të përcaktuara për ta bërë ndërmjetësimin të disponueshëm që t'ju lejojë ju dhe distriktin shkollor të zgjidhni mosmarrëveshjet lidhur me çdo çështje sipas Pjesës B ose Pjesës C të *IDEA*, duke përfshirë çështje të ngritura para bërjes së një ankese shtetërore apo ankese me proces të rregullt. Si pasojë, ndërmjetësimi është i disponueshëm për të zgjidhur konflikte sipas Pjesës B ose Pjesës C të *IDEA*, pavarësisht nëse keni bërë ankese me proces të rregullt për të kërkuar seancë dëgjimore siç përshkruhet nën titullin, **Bërja e Ankesës me Proces të Rregullt**.

Kërkesat

Procedurat sigurojnë që procesi i ndërmjetësimit:

1. Është vullnetar nga ana juaj dhe e distriktit shkollor;
2. Nuk përdoret për të mohuar apo vonuar të drejtën tuaj për një seancë dëgjimore në proces të rregullt, apo për të mohuar asnjë të drejtë tjetër që keni sipas Pjesës B ose Pjesës C të *IDEA*; dhe
3. Kryhet nga një ndërmjetës i paanshëm që është i trajnuar për metoda efektive ndërmjetësimi.

Distrikti shkollor mund të zhvillojë procedura që i ofrojnë prindërve dhe shkollave që zgjedhin të mos përdorin procesin e ndërmjetësimit një mundësi për tu takuar, në një vend dhe kohë të përshtatshme për ty, me një palë të pa interesuar:

1. E cila është nën kontratë me një entitet të përshtatshëm për zgjidhjen e konflikteve, ose në një qendër trajnimi dhe informimi për prindërit ose qendër komunitare burimesh për prindërit në Shtet; dhe
2. E cila do t'ju shpjegonte përfitimet dhe t'ju inkurajontë për përdorimin e procesit të ndërmjetësimit.

MDE duhet të mbajë një listë të personave të kualifikuar për të qenë ndërmjetësues dhe njohin ligjet e rregulloret lidhur me ofrimin e shërbimeve të edukimit special e të tjera të ngjashme. *MDE* duhet të zgjedhë ndërmjetësuesit në bazë rastësore, rotacioni apo mënyrë tjetër të paanshme.

Shteti është përgjegjës për koston e procesit të ndërmjetësimit, përfshirë koston e takimeve. Këto shërbime ofrohen nga [Shërbimet e Ndërmjetësimit për Edukimin Special](http://MiKids1st.org) (<http://MiKids1st.org>).

Çdo takim në procesin e ndërmjetësimit duhet të planifikohet në kohën e duhur dhe të mbahet në një vend të përshtatshëm për ju dhe distriktin shkollor.

Nëse ju dhe distrikti shkollor zgjidhni një konflikt përmes procesit të ndërmjetësimit, të dyja palët duhet të hyjnë në një marrëveshje të vlefshme ligjore që përcakton zgjidhjen dhe:

1. Pohon se të gjitha diskutimet e kryera gjatë procesit të ndërmjetësimit mbeten konfidenciale dhe nuk mund të përdoren si provë në ndonjë seancë dëgjimore të një procesi të rregullt apo procedimi civil të mëvonshëm; dhe
2. Firmoset nga ju dhe një përfaqësues i distriktit shkollor i cili ka autoritet për të përfshirë distriktin shkollor.

Një marrëveshje e shkruar dhe e firmosur është detyruese në çdo gjykatë të Shtetit me juridiksionin përkatës (një gjykatë që ka autoritet të mbajë seanca dëgjimore për çështje të tilla sipas ligjit të Shtetit) ose në një gjykatë distrikti të Shteteve të Bashkuara.

Diskusimet që kanë ndodhur gjatë procesit të ndërmjetësimit duhet të jenë konfidenciale. Ato nuk mund të përdoren si provë në ndonjë seancë dëgjimore të një procesi të rregullt apo procedimi civil të ndonjë gjykate federale apo shtetërore të një shteti që merr asistencë sipas Pjesës B ose Pjesës C të *IDEA*.

Paanshmëria e ndërmjetësit

Ndërmjetësi:

1. Nuk duhet të jetë punonjës i *MDE* apo distriktit shkollor të përfshirë në edukimin apo kujdesin ndaj fëmijës tuaj; dhe
2. Nuk duhet të ketë interes personal apo profesional që është në konflikt me objektivitetin e ndërmjetësit.

Një person i kualifikuar si ndërmjetës nuk është punonjës i një distrikti shkollor apo agjensie Shtetërore thjesht sepse paguhet nga agjensia apo distrikti shkollor për të shërbyer si ndërmjetës.

Procedurat e Ankesave Shtetërore

Ndryshimi Midis Ankesave për Seanca Dëgjimore me Proces të Rregullt dhe Procedurave të Ankesave Shtetërore

Rregulloret për Pjesën B të *IDEA* parashtrojnë procedura të ndara për ankesat Shtetërore dhe ankesat me proces të rregullt dhe seanca dëgjimore. Siç përshkruhet më poshtë, çdo individ apo organizatë mund të ngrejë një ankesë Shtetërore mbi një shkelje të çdo kërkesë të Pjesës B ose Pjesës C nga një distrikt shkollor, *MDE* ose çdo agjensi publike. Vetëm ju ose një distrikt shkollor mund të bëni një ankesë me proces të rregullt për çdo çështje lidhur me propozimin apo refuzimin për të ndryshuar identifikimin, vlerësimin apo vendndodhjen e edukimit për një fëmijë me aftësi të kufizuara, apo ofrimin e *FAPE* ndaj fëmijës. Teksa stafi i *MDE* përgjithësisht duhet të zgjidhë ankesat Shtetërore brenda 60 ditësh kalendarike, nëse afati nuk shtyhet në mënyrë të përshtatshme, një *ALJ* duhet të dëgjojë një ankesë me proces të rregullt (nëse nuk është zgjidhur me takim apo përmes ndërmjetësimit) dhe të lëshojë një vendim me shkrim brenda 45 ditësh kalendarike pas përfundimit të periudhës së zgjidhjes, siç përshkruhet në këtë dokument nën titullin, **Procesi i Zgjidhjes**, nëse *ALJ* nuk garanton një shtyrje specifike të afatit sipas kërkesës tuaj apo të distriktit shkollor. Ankesa shtetërore dhe ankesa me proces të rregullt, zgjidhja dhe procedurat e seancave dëgjimore përshkruhen me në tërësi më poshtë.

Adoptimi i Procedurave të Ankesave Shtetërore

34 CFR §300.151

Të Përgjithshme

MDE duhet të ketë procedura të shkruara (shiko Rregullat Administrative për Edukimin Special, Rregulli 340.1701a, 340.1851-1853) për:

1. Zgjidhjen e një ankese shtetërore, përfshirë një ankesë të bërë nga një organizatë apo individ i një shteti tjetër.
2. Bërja e ankesës.
3. Shpërndarjen e gjerë e ankesës Shtetërore tek prindërit dhe individët e tjerë të interesuar, duke përfshirë trajnimin e prindërve dhe qendrat e informimit, agjensitë e mbrojtjes dhe këshillimit, qendrat pavarura të banimit, dhe entitete të tjera të përshtatshme.

Riparimet për mohimin e shërbimeve të përshtatshme

Në zgjidhjen e një ankese Shtetërore në të cilën *MDE* ka gjetur një dështim në ofrimin e shërbimeve të përshtatshme, *MDE* duhet të adresojë:

1. Dështimin në ofrimin e shërbimeve të përshtatshme, duke përfshirë veprime korigjuese të përshtatshme për të adresuar nevojat e fëmijës; dhe
2. Ofrim i mëtejshëm i përshtatshëm i shërbimeve për të gjithë fëmijët me aftësi të kufizuara.

Procedurat Minimale për Ankesat Shtetërore

34 CFR §300.152

Limiti kohor; procedurat minimale

MDE, përmes Zyrës së Edukimit Special [*Office of Special Education (OSE)*], do të përfshijë në procedurat e ankesave Shtetërore një limit kohor prej 60 ditësh kalendarike pasi kërkes është bërë:

1. Për të kryer një hetim të pavarur në terren, nëse *MDE* vendos se hetimi është i nevojshëm.
2. Për t'i dhënë ankuesit mundësinë për të dorëzuar informacion shtesë, me shkrim ose me gojë, për akuzat në ankesë.
3. T'i japë distriktit shkollor apo një agjensie tjetër publike mundësinë për t'ju përgjigjur ankesës, duke përfshirë, minimalisht: (a) në opsionin e agjensisë, një propozim për ta zgjidhur ankesën; dhe (b) një mundësi për një prind që ka dërguar ankesën dhe agjensinë për të rënë dakort vullnetarisht për ndërmjetësim;
4. Për të rishikuar të gjithë informacionin e duhur dhe të marrë një vendim të pavarur nëse distrikti shkollor apo agjensia publike po shkel një kërkesë të Pjesës B të *IDEA*; dhe
5. Për t'i lëshuar një vendim me shkrim ankuesit që adreson akuza të tilla në ankesë dhe përmban: (a) gjetje të fakteve dhe përfundime; dhe (b) arsyet për vendimin përfundimtar të *MDE*

Shtyrja e kohës; vendimi final; implementimi

Procedurat e *MDE* të përshkruara më sipër duhet gjithashtu:

1. Të lejojnë shtyrje të afatit 60 ditor kalendarik vetëm nëse: (a) ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme kundrejt një ankesë Shtetërore të veçantë; ose (b) prindi dhe distrikti shkollor ose agjensia publike të përfshirë bien dakort vullnetarisht të shtyjnë afatin për ta zgjidhur çështjen përmes ndërmjetësimit;
2. Të përfshijnë procedurat për implementim efektiv të vendimit përfundimtar të *MDE*, nëse nevojitet, duke përfshirë: (a) aktivitete asistence teknike; (b) negociata dhe (c) veprime korigjuese për të arritur përmbushjen.

Ankesat shtetërore dhe seancat dëgjimore të procesit të rregullt

Nëse merret një ankesë Shtetërore që është gjithashtu objekt i seancave dëgjimore të një procesi të rregullt siç përshkruhet më poshtë nën titullin **Bërja e një Ankese me Proces të Rregullt**, ose ankesa Shtetërore përmban disa probleme nga të cilat një ose më shumë janë pjesë e kësaj seance, Shteti duhet të vendosë veçmas ankesën Shtetërore apo çdo pjesë të saj që po adresohet në procesin e rregullt deri në përfundim të seancës dëgjimore. Çdo problem në ankesën Shtetërore që nuk është pjesë e seancave dëgjimore të procesit të rregullt duhet të zgjidhet duke përdorur limitin kohor të procedurave të përmendura më sipër.

Nëse një problem i ngritur në një ankesë Shtetërore është vendosur më parë një seancë dëgjimore të një procesi të rregullt duke përfshirë të njëjtat palë (ju dhe distrikti shkollor), atëherë vlen vendimi i seancës dëgjimore dhe *MDE* duhet të informojë ankuesin se vendimi është i vlefshëm.

Një ankesë që akuzon paaftësinë e distriktit shkollor apo të një agjensie publike për të implementuar vendimin e seancës dëgjimore të procesit të rregullt duhet të zgjidhet nga *MDE*.

Bërja e një Ankese Shtetërore

34 CFR §300.153

Një organizatë ose individ mund të bëjë një ankesë Shtetërore të shkruar e firmosur sipas procedurave të mëposhtme.

Ankesa Shtetërore duhet të përfshijë:

1. Një deklaratë që një distrikt shkollor apo agjensi tjetër publike ka shkelur:
 - a. Çdo ofrim aktual të rregullave administrative për edukimin special;
 - b. 1976 PA [*Public Act* – Akti Publik] 451, *MCL* [*Michigan Compiled Laws* – Ligjet e hartuara të Michigan] 380.1 dhe për më tutje, siç është në fuqi për programet dhe shërbimet e edukimit special;
 - c. Akti i edukimit për individët me aftësi të kufizuara i 2004, 20 U.S.C 33, §1400 dhe për më tutje, dhe rregulloret që implementojnë aktin, 34 *C.F.R.* pjesa 300, dhe 34 *C.F.R.* pjesa 303; Faktet në të cilat mbështetet deklarata;
 - d. Një plan i distriktit shkollor të ndërmjetëm;
 - e. Një raport i individualizuar i programit të edukimit, vendimi i zyrës së seancës dëgjimore, apo vendimi i gjykatës për programet apo shërbimet e edukimit special; ose
 - f. Aplikimin e shtetit për fonde federale sipas *IDEA*;
2. Firmën dhe të dhënat e kontaktit për ankuesin; dhe
3. Nëse akuzat lidhen me një fëmijë specifik:
 - a. Emrin e fëmijës dhe adresën e banimit të fëmijës;

- b. Emri i shkollës që fëmija ndjek;
- c. Në rastin e një fëmije apo të riu të pastrehë, të dhënat e kontaktit të disponueshme për fëmijën dhe emri i shkollës që ndjek;
- d. Një përshkrim i natyrës së problemit të fëmijës, duke përfshirë faktet e lidhura me problemin; dhe
- e. Një zgjidhje e propozuar për problemin nën dijeninë e palës që bën kërkesën në momentin e kryerjes.

Ankesa duhet të përmbajë akuza për shkelje jo më shumë se një vit para datës kur ankesa merret nga *MDE* apo *ISD* [*Intermediate School District* – Distrikti Shkollor i Ndërmjetëm].

Pala që bën ankesën Shtetërore duhet t'i dërgojë një kopje të ankesës distriktit shkollor apo agjensisë tjetër publike që i shërben fëmijës në të njëjtën kohë kur ankesa i dërgohet *OSE*.

MDE ka zhvilluar një formular shembull për të ndihmuar bërjen e ankesës Shtetërore. Formulari shembull gjendet në [OSE faqja zyrtare](http://www.michigan.gov/specialeducation) (www.michigan.gov/specialeducation). Ju nuk jeni i detyruar ta përdorni formularin shembull. Sidoqoftë, ankesa duhet të përmbajë informacionin e kërkuar për të bërë një ankesë Shtetërore (Shiko 1-4 më sipër).

Procedura e procesit të ankesës

Plotësimi i një procesi ankimi

34 CFR §300.507

Të Përgjithshme

Ju ose shkolla e zonës mund të aplikoni një proces ankese për çdo çështje të lidhur me një propozim ose refuzim për të filluar ose ndryshuar identifikimin, vlerësimin ose vendosjen edukative të fëmijës tuaj, ose dispozitën e nje *FAPE* për fëmijën tuaj.

Ankesa e procesit duhet të pohojë një shkelje ka ndodhur jo më shumë se dy vjet para se ju ose shkolla e zonës të njihni ose duhet të keni njohur për veprimin e supozuar që përbën bazën e procesit të ankimit.

